

# community

The New Apostolic Church around the world

01/2017/AI

Motoja për vitin 2017:

Lëvduar qoftë

Perëndia, Ati ynë

Shërbesë fetare në Brazil:  
Dashuria për Jezusin

Katekizmi:  
Lutja dhe sakrifica

Katekizmi:  
Martesa dhe familja

New Apostolic Church  
International



# Lëvduar qoftë Perëndia, Ati ynë

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

„Lëvduar qoftë Perëndia, Ati ynë“ – kështu thuhet në letrën e apostulit Pal drejtuar Filipianëve. Është një mendim i lashtë për t'i dëshmuar lavdi atij Perëndie, i cili ka bërë dhe krijuar gjithshka, pra për të lëvduar hapur fuqinë e tij dhe për të shpallur me zë të lartë mirësinë e pafundme të tij. E përsëri, njerëzit i janë larguar vazhdimisht kësaj sjelljeje. Në të kundërt: ata bëjnë përgjegjës Perëndinë për të gjitha vështirësitë e jetës së tyre!

## Apelli im është sot: Le t'i japim Perëndisë, Atit tonë lavdinë!

Kjo nuk duhet të jetë vetëm zgjedhja e vitit 2017, por duhet ta përcaktojë rrugën e mëtejshme të jetës dhe të besimit tonë. Të lëvdosh Perëndinë, Atin – si mund të ndodhë kjo? Po përmend me shembuj tri detyra:

- Të dallojmë madhësinë e Perëndisë! Ai është krijuesi prej të cilit vjen gjithshka, si krijimi i dukshëm ashtu edhe historia e shpëtimit shpirtëror. Është detyrë e jona për ta trajtuar me mënçuri dhe mirësi krijimin e tij. Perëndia ka dhënë të mirat natyrore; megjithatë përgjegjësia për shpërndarjen dhe ruajtjen e tyre qëndron tek ne, tek njerëzit.
- Le ta falenderojmë atë për të gjitha dhuntitë e tija, duke e bërë vullnetin e tij edhe atëherë, kur kjo na e bën më të vështirë jetën. Le t'i sjellim atij sakrificë. Le t'i besojmë më shumë atij, se sa të ankojemi për shqetësimet tona. Ai kujdeset për ne edhe pse jemi mëkatarë. Nga ana tjetër edhe ne duam të respektojmë dinjitetin e çdo qenie njerëzore. Perëndia është Ati i të gjithëve! Ne e nderojmë Atin tonë kur kërkojmë shpëtim edhe për ata, të cilët na kanë lëvduar.
- Të shpallim lavdinë e tij duke u sjellë si fëmijë të tij. Përpara Perëndisë ne jemi si fëmijë: Ne dimë pak, ai di



NAC International

gjithshka. Është e rëndësishme ta njohim autoritetin e tij dhe të vihem me vullnet të plotë nën shërbimin e tij. Kjo nuk është për ne një kufizim i lirisë sonë, porse një burim bekimi!

Ne duam t'i japim Perëndisë, Atit tonë, lavdinë: Ai është më i madh se gjithshka, asgjë nuk mund ta ndalojë atë për të na dhënë mbetërinë e tij. Jeta e tij, të cilën e ka vendosur brenda nesh duhet të zhvillohet. Kështu, ne do të kontribuojmë për unitet në mesin e fëmijëve të tij, në dijen se për të gjithë ka vetëm një Perëndi dhe një At, i cili është „mbi gjithshka, nëpërmjet të gjithëve dhe tek të gjithë“.

Programi trepikësh për vitin 2017 është:

- Të dallojmë lavdinë e Perëndisë, të Atit në veprat e tija.
- Ta falenderojmë atë për mirësitë e tija.
- Të shpallim lavdinë e tij duke u sjellë si fëmijë Perëndie.

Në këtë aspekt, ju uroj për vitin e ri shumë gëzim dhe bekimet e Perëndisë!





Shërbesën fetare të 28 shtatorit të 2016, apostuli kryesor e mbajti në Gramado/Brazil. Qyteti shtrihet në jug të 27 shteteve, në Rio Grande do Sul.



Luka 7,47.48

*Prandaj unë po të them se mëkatet e saja të shumta i janë falur, sepse ka dashur shumë; po kujt i falen pak, do pak. Pastaj i tha asaj: Mëkatet e tua të janë falur.*

## Dashuria për Jezusin

Shumë të dashur motra e vëllezër, është një kënaqësi për mua që kam mundësinë ta përjetoj këtë shërbesë fetare me ju. Jam menduar rreth asaj, se çfarë kërkon të na thotë Perëndia sot dhe mendimi i parë që më erdhi në mendje ishte se nuk duhet ta humbasim guximin. E di shumë mirë që s'është e lehtë të jesh apostolik i ri këtu në këtë vend, pasi numri i motrave e vëllezërve është i vogël dhe bashkësitë janë shumë larg nga njëra-tjetrës. Mund ta imagjinoj se aty-këtu mund të lindë mendimi: Ekzistojnë kaq shumë komunitete fetare në këtë vend, të cilat kanë arritur një sukses të madh, ndërsa ne kemi kaq pak sukses në punën e Perëndisë. Të tjerët kanë kanale televizive dhe para, ndërsa ne jemi një bashkësi kaq e vogël. Çfarë duhet të bëjmë?

Përgjigja është shumë e thjeshtë. Kujtoni këtë ndodhi: Pjetri kishte peshkuar gjatë gjithë natës dhe s'kishte zënë asgjë. Vjen Jezusi dhe i thotë: „Dil në ujëra të thella dhe hidh rrjetat për të zënë peshk!“ Pjetri ishte peshkatar për nga zanati. Ai e dinte: kjo nuk do të kishte rezultat, megjithatë i tha: „Sipas fjalës tënde, po i hedh rrjetat“ (Lk 5,4.5). Ai u nis dhe bëri një peshkim të mrekullueshëm. Vetë Zoti e ka përdorur këtë ngjarje si një figurë për përhapjen e Ungjillit. Të dashur motra e vëllezër, le të kujdesemi që mësimi i apostujve të mund të vazhdojë edhe më tutje. Nuk është e rëndësishme se sa shumë mjete kemi në dispozicion dhe se cilat metoda përdorim. Ne nuk jemi të interesuar për të fituar sa më shumë anëtarë për Kishën Apostolike të Re, nuk është ky qëllimi ynë. Po ashtu as për të sjellë sa më shumë njerëz në mënyrë që të sakrifikojnë.

Bëhet fjalë për të gjetur nxënës, të cilët e ndjekin me të vërtetë pas Zotin Jezus. Është e rëndësishme për të gjetur shpirta, që mund të numërohen ndër bashkësinë nuse të Zotit. Ky është qëllimi, dhe jo metodat e ndryshme. Vlen vetëm një gjë, që të veprimet njësoj si Pjetri: thjesht të zbatohet vullnetin e Jezu Krishtit. Motra e vëllezër, ky duhet të jetë edhe në vazhdim qëllimi ynë: Ne të gjithë përpiqemi për të zbatuar Ungjillin, për të jetuar në jetën e përditshme ashtu si Zoti pret prej nesh. Shembulli ynë do të tërheqë ata njerëz, të cilët Perëndia dëshiron t'i sjellë drejt vetes. Le të vazhdojmë të punojmë kështu, ta vëmë në praktikë Ungjillin, të ndjekim pas Zotin dhe të tërheqim me anë të sjelljes sonë njerëz drejt nesh.

Po e them përsëri: Nuk bëhet fjalë për të gjetur anëtarë për Kishën Apostolike të Re. Bëhet fjalë për të gjetur nxënës të vërtetë, që ecin me të vërtetë sipas Jezusit dhe që dëshirojnë të përgatiten për ditën e Zotit.

Fjala e lexuar ndoshta tingëllon paksa jo e zakonit. Për ta përshkruar shkurtimisht: Ajo është qëndron në kontekst me vizitën që Jezusi i bëri Simonit, një fariseu. Gjatë vaktit brenda hyri një grua. Të gjithë e njihnin si mëkatore. Ajo nisi të qajë, ia lagu Jezusit këmbët me lotët e saj, ia puthi, ai thau me flokët e saj dhe ia leu me vaj. Të gjithë të pranishmit mbetën të indinjiruar: Pse e lejon ai këtë grua, këtë mëkatore të veprimet kështu, ajo vetëm pengon! Jezusi ua dinte mendimet dhe i bën një pyetje Simonit: „Një huadhënës kishte dy huamarrës; njëri i kishte borxh pesëqind monedha argjendi dhe tjetri pesëdhjetë. Meqë ata nuk kishin si të paguanin, ai ua fali të dyve. Thuaj, pra, cili nga ata do ta dojë më shumë?“ (Lk 7,41.42). Kjo ishte e

qartë: ai që mori pesëqind e donte më shumë. Dhe më pas vijon përgjigja e Jezusit: „Mëkatet e saja të shumta i janë falur, sepse ka dashur shumë“ (Lk 7,47). Jezusi me këtë kërkonte të thoshte: Ne duhet ta duam Perëndinë, sepse ai na do. Kjo vlen për të gjithë ne.

Ne duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm se Jezusi na i fal mëkatet. Përgjigja jonë mbi mëshirën dhe dashurinë e tij është, që edhe ne e duam atë.

Çfarë nënkupton që Perëndia na i fal mëkatet? Së pari kjo do të thotë se Jezu Krishti, Biri i Perëndisë vuajti dhe vdiq për ne. Rreth kësaj nuk kërkoj të them shumë fjalë, por është bukur kur merremi pak më shumë me këtë gjë, me atë që mori Jezusi përsipër nga dashuria për ne. Të

dashur vëllezër, të dashura motra, kjo është dëshmia më e madhe e dashurisë që Jezu Krishti na ka dhënë: Ai ka dhënë jetën për ty! Kur ne pastaj i themi Perëndisë së dashur: A më do?, kjo është paturpsi e parë nga ana njerëzore. Krishti dha jetën

për ne! Çfarë duhet të bëjë akoma më shumë Perëndia, se sa të sakrifikojë edhe Birin e tij? Jezu Krishti dha jetën për ne ngaqë na do dhe për të na i falë mëkatet.

Mëkatet e parë, të cilin ai na e ka falur është mëkati i trashëguar. Mëshira e parë që na u dhurua, është mëshira e pagëzimit. Ai na e lau mëkatet e trashëguar dhe na ka bërë kështu të aftë për të hyrë në bashkësi me Perëndinë. Kjo ndoshta tingëllon shumë teorike, por merru njëherë me këtë. Me anë të pagëzimit neve njerëzve të varfër na u bë e mundur të kemi bashkësi me Perëndinë.

Pastaj ai na fal mëkatet individuale. Sa herë që nuk veprimet sipas vullnetit të Perëndisë, sa herë që nuk jetojmë sipas Ungjillit ne mëkatojmë dhe çdo mëkat na pengon rrugën drejt bashkimit.

Përfuturo, ti ke mundësinë për të hyrë në bashkësi me Perëndinë, por ngaqë ke mëkatuar rruga është mbyllur. Po mirë, ne s'është se po vrasim çdo ditë një njeri, megjithatë ekzistojnë shumë mëkate të vogla, që na e pengojnë rrugën drejt bashkimit me Perëndinë. Nëse nuk veprimet sipas dhjetë urdhëresave, ne mëkatojmë. Ia vlen t'i lexosh edhe një herë dhjetë urdhëresat dhe të pyesësh veten: A i kam zbatuar të tëra? Sa herë që shkelim urdhrin e dashurisë për tjetrin, ne mëkatojmë. Ne jemi nganjëherë kaq bujarë me veten. I kemi Premtuar diçka Perëndisë dhe s'e kemi mbajtur flalën. Atëherë kemi aq shumë justifikime.





Sa herë që kemi pasur mundësinë për të bërë mirë, ose duhej të bënim mirë dhe së kemi bërë, ne mëkatojmë. Nëse mendon rreth kësaj atëherë e kupton se sa shpesh mëkatojmë. Por mëshira e Jezu Krishtit i largon të gjitha mëkatet. Mendoj shpesh për këtë. Perëndia është i gjithëdituri, ai di gjithëshka. Ai nuk mund të harrojë asgjë, pasi për të e shkuara dhe e ardhmja janë një.

Unë vë re tek vetja se po plakem dhe se harroj, por Perëndia nuk harron asgjë. Por në qoftë se ai na fal, na i largon të gjitha; mëkati nuk ekziston më dhe është sikur të mos e kishim bërë kurrë.

Ne e kemi kaq të vështirë për të falur shtatëdhjetë herë shtatë herë, ashtu si ka thënë Jezusi (Mt 18,22). Një herë tjetër ka thënë: Ti duhet ta falësh vëllanë tënd shtatë herë në ditë (Lk 17,4). A mund të kërkohet diçka e tillë? Kjo është e

tepërt! - A e ke menduar ndonjëherë se sa herë të janë falur ty të po të njëjtat mëkate?

Zoti na i fal. Ai ka dhënë jetën për ne. Mëkati i trashëguar u la, me qëllim që të mund të kemi bashkësi me të. Ne na

falen ato mëkate, të cilat na e mbyllin rrugën drejt bashkimit me të. Meqë Zoti e ka bërë këtë, ne e duam atë. Po si e shprehim ne dashurinë tonë? Ne i qëndrojmë atij besnik, pasi përjetojmë nëpërmjet mëshirës së tij, dashurinë

e tij. Ne i mbetemi atij besnik, pasi e duam atë edhe kur nuk na i dëgjon ndonjëherë lutjet tona, edhe kur nuk na i realizon dëshirat, edhe kur nuk e kuptojmë fare atë, edhe kur nuk e shohim bekimin e tij.

Prapëseprapë ne vazhdojmë të qëndrojmë me të. Ne i qëndrojmë atij besnik, sepse kemi përjetuar dashurinë e tij.

## *Nga dashuria ne i mbetemi besnik atij edhe nëse nuk e kuptojmë atë.*

400 motra e vëllezër të besimit morën pjesë në këtë shërbesë fetare, disa prej të cilëve kanë bërë një rrugë prej më shumë se 1000 km.



Si shprehet ndryshe dashuria jonë? Ajo shprehet duke i shërbyer atij. Duke bërë atë që ai kërkon prej nesh.

Ne duam të bëjmë mire, duam të qëndrojmë në shërbim të Zotit – edhe në jetën e përditshme. Pasi e duam, kërkojmë ta ndihmojmë. E dimë, puna jonë konsiston në atë, për të ndihmuar të gjithë njerëzit që të mund ta gjejnë atë. Ne dëshirojmë ta ndihmojmë, pasi ai është kaq i mirë me ne. Pasi e duam, jemi mirënjohës dhe bëjmë atë çfarë i pëlqen. Dhe çfarë i pëlqen atij? I pëlqen që ne ta falim tjetrin. Këtë ne e bëjmë nga dashuria ndaj tij. Ai na ka falur aq shumë. Ai na ka shpëtuar. Tani, ai vjen tek unë dhe thotë: „Kam një lutje për ty: A mund ta falësh të lutem tjetrin?“ Këtu s’mund të them: „jo, këtë s’e bëj! Po më kërkon shumë!“ Këtu më duhet të mendoj mirë njëherë të gjitha ato që Zoti Jezus ka bërë për mua. Vetëm prej dashurisë për të, unë bëj atë që ai kërkon prej meje dhe e fal tjetrin.

Më lejoni ta përmbledh: Ne dëshirojmë të jemi gjithnjë të vetëdijshëm se sa shumë mëshirë na ka dhuruar Perëndia. Biri i Perëndisë ka dhënë jetën për ne. Ai na ka çliruar nga mëkati i trashëguar, me qëllim që të mund të kemi bashkësi

me Perëndinë. Dhe ai është gjithmonë i gatshëm për të na i falur mëkatet e vogla dhe të mëdha, edhe njëqind herë nëse duhet. Ai e lan fajin, e bën atë të paekzistueshëm. Pasi Perëndia na fal kaq shumë, ne dëshirojmë ta duam atë. Nga dashuria, ne i mbetemi besnik atij edhe kur nuk e kuptojmë edhe kur nuk na jep atë çfarë i kemi kërkuar; ne i shërbejmë atij, e prej dhashurisë që kemi për të ne e falim tjetrin.

Jezusi thotë këtu: „mëkatet e shumta të saja i janë falur, pasi ajo ka treguar shumë dashuri.“ Njeriu mund t,i kuptojmë këto fjalë edhe ndryshe: sepse ajo ka dashur, ai e fali atë. Pra një deklaratë e arsyeshme. Por Jezusi e tha arsyen se përse e fali atë: „Besimi yt të shpëtoi; shko në paqe!“ Për të marrë faljen e mëkateve duhet të kesh besim. Ky është një kusht i domosdoshëm. Duhet të besosh në Jezu Krisht. Duhet të besosh, që ai është Biri i Perëndisë. Të besosh që ai vdiq për ne. Të besosh që është ringjallur. Pa besimin tek ai, askush s’mund të shpëtohet. Por mbi të gjitha ne besojmë se apostujt na i falin mëkatet dhe kanë forcë hyjnore për të shpallë këtë falje. Për të marrë faljen e mëkateve duhet të ekzistojë një besim i vërtetë.





Nga se dallohet që besimi është i vërtetë, se është i fortë? Apostuli Pal e ka thënë shumë qartë: Besimi që na shpëton, vepron në dashuri (Gal 5,5.6). Ky është besimi i vërtetë.

Për ta marrë mëshirën e pagëzimit duhet të besosh në Jezu Krisht. Mund të pagëzohet vetëm ai që pohon, dëshmon: Unë besoj në Jezu Krisht. Po si ndikon ky besim? Nga dashuria që ke për Zotin, dëshiron ta ndjekësh pas atë. Ai që pagëzohet pohon: Unë dua t'i them jo të keqes dhe të ndjek pas Jezu Krishtin. Unë ia dorëzoj jetën time Zotit Jezus. Ndryshe, pagëzimi është veç një traditë, pa asnjë lloj efekti. Me qëllim që mëshira e pagëzimit të ndikojë, duhet të keshë një besim të fortë në Jezu Krisht. Ky besim vepron në dashuri. Njeriu kërkon ta ndjekë pas Jezu Krishtin, të jetoj sipas Ungjillit të tij. Ai është shembulli ynë. Pasi Jezusi na ka çliruar nga mëkati i trashëguar, ne e duam atë dhe ecim sipas tij.

Me faljen e mëkateve është njësoj: Për të pasur mundësinë e përjetimit të faljes duhet të besojmë në Jezu Krisht. Ne besojmë në Jezu Krisht. Besojmë tek apostujt e tij dhe ky besim bëhet aktiv me anë të dashurisë.

Kur ne e duam me të vërtetë Jezu Krishtin, atëherë pyesim vazhdimisht veten: A i kam pëlqyer atij? Apo mos ka diçka tek unë, që e shqetëson atë? Kjo është shprehje e dashurisë: Njeriu kërkon t'i pëlqejë tjetrit dhe e provon gjithmonë veten. A ka diçka tek unë që nuk i pëlqen Zotit Jezus?

Ky vetëkontroll është patjetër i domosdoshëm për marrjen e faljes së mëkateve. Kur unë e dua Zotin Jezus, atëherë unë vuaj prej mëkateve të mija. Atëherë nuk them: „nuk është edhe aq keq, edhe të tjerët kështu veprojnë!“ Kur jam i ndërgjegjshëm se rruga drejt Jezusit më pengohet për shkak të një budallallëku apo diçkaje të vogël, kur nuk mund të shkoj më tek ai, atëherë nuk quhet më i vogël asnjë mëkat. Prej kësaj gënjështre të vogël, sepse kam bërë diçka të vogël apo s'e kam bërë, unë nuk mund t'i afrohem më Zotit Jezus! Atëherë mëkati na bëhet një dhimbje. Ne vuajmë prej veprimeve tona ose prej lëshimeve tona, pasi nuk kemi bërë atë çfarë duhej të bënim. Pasi e duam Zotin, vuajmë prej mëkateve tona.

Sepse e duam Zotin, i vëmë vetes si qëllim: Kjo duhet të bëhet ndryshe, unë kërkoj të përmirësohem! Unë kërkoj



t'i pëlqejë Zotit Jezus, dua të shkojë tek ai! Kjo duhet të ndryshojë! Nga dashuria për Zotin jemi edhe të gatshëm për ta falur tjetrin. Sepse i bën vetes pyetjen: Çfarë është për mua më e rëndësishme? Bashkimi me Krishtin apo që të kem unë me patjetër të drejtë, që të gjithë ta shohin se tjetri nuk ka, se ai duhet dënuar? Nga dashuria për Zotin ne themi: Ah, s'do t'ju japim rëndësi, dua bashkimin me Krishtin! Nga dashuria për Zotin njeriu është gati për pajtim, sepse e dimë se ai dëshiron që të jemi një, që të jetojmë në unitet. Ai nuk kërkon mosmarrëveshje midis njerëzve. Nga dashuria ndaj tij ne jemi më pas gati për t'u pajtuar me tjetrin.

Aty ku ekziston prova ndaj vetes, ku gjëndet vullneti për përmirësim, ku vuan prej mëkateve të tua dhe ku ka pendesë, aty ku je i gatshëm për të falur tjetrin dhe për t'u pajtuar me të, aty mund të përjetosh faljen e mëkateve. Kaq e thjeshtë është të dashur motra e vëllezër. Ne dëshirojmë të merremi pak më shumë me këto mendime, me mëshirën, që Zoti Jezus na ka dhuruar. Meqë mëshira e tij është kaq e madhe, ne dëshirojmë ta duam atë. Ne i mbetemi atij besnik, çfarëdo që të ndodhë. Ne i shërbejmë atij. Falim të afërmin tonë sepse duam t'i pëlqejmë atij. Kërkojmë të kemi një besim të fortë, që është aktiv në dashuri. Ne provojmë gjithmonë vetveten. Ne kërkojmë të përmirësohemi. Duam t'i ngjasojmë sa më shumë Zotit Jezus. Ne vuajmë prej mëkateve tona, pendohemi për to, kërkojmë ta falim tjetrin

e të pajtohemi me të. Ne duam ta ndjekim pas Zotin dhe të kemi një bashkim të përgjeshëm me të dhe kudo ku ky besim, i cili vepron në dashuri ekziston, ne marrim falje.

Të dashur motra e vëllezër, ky nuk duhet të ishte një referat teologjik; merreni si mendime prej Shpirtit të Shenjtë, me të cilat ne dëshirojmë të merremi dhe mund t'ju siguroj se, sa më shumë të merremi me këtë mendim, aq më shumë do të na bekojë Perëndia.

## MENDIME KYÇE

Ne e duam Jezu Krishtin pasi ai na dhuron faljen e tij. Për ta marrë atë, ne duhet të besojmë në Jezu Krisht. Besimi i vërtetë shprehet në dashurinë ndaj Krishtit.





# Të shërbesh me dashuri, jo të sundosh

Të gjithë vëllezërit e administratës aktivë si dhe ata tashmë në pension të Shqipërisë dhe të vendit fqinjë Kosovës u mblodhën sëbashku në shërbesën fetare të apostulit kryesor Jean-Luc Schneider. Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider predikoi në Tiranë më 9 Korrik 2016.

Rojet dhe shtëpia e Izraelit u bënë një tablo për vëllezërit dhe për kishën dhe për bashkësitë në kohën e sotme. „Thuhet: ‚Unë të caktova.‘ është pra një thirrje e Perëndisë. Ai na ka thirrur të shërbejmë, jo një njeri, jo një organizatë“, theksoi apostuli kryesor Schneider. Dhe Perëndia na bën thirrje të shërbejmë; një vëlla administrate është pra një shërbëtor Zotit! Për më tepër marrja e një detyre apo posti nuk është e lidhur me avantazhe: „Ne nuk u bëmë vëllezër administrate, shërbëtor Perëndie, me qëllim që jeta jonë të jetë më e mirë“ shpjegoi drejtuesi i kishës. Është një shërbim që i bëjmë Zotit dhe bashkësisë.

## Jo mjet, instrument-për shpëtim

Përbushja e detyrës nuk na mundëson automatikisht marrjen e shpëtimit, çlirimit hyjnor. Ato janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme: „njeriu mund të jetë një shërbëtor shumë i mirë, mund të bëjë një punë krejtësisht fantastike në punën e Zotit e megjithatë mund të mos jetë prezent në ditën kur zoti të vijë.“ Posti dhe detyra nuk të ndihmojnë për të fituar lumturinë, shenjtërinë personale. Apostuli kryesor Schneider tha konkretisht: „Unë nuk mund të vi para Jezusit dhe t’i them: ‚O Zot, unë kam qenë apostuli

Shqipëria është nën kujdesin administrativ të zonës kishtare të Vestfalisë së Rinit Verior/Gjermani. 200 motra e vëllezër janë të shpërndarë nëpër 6 bashkësi: në Tiranë, Elbasan, Fier, Lushnje, Kuçovë dhe Ura Vajgurore.



yt kryesor, ti duhet të më marrësh edhe mua me vete! Ai mund të më përgjigjej mua: 'Jo, ti ke qenë vetëm një vegël në duart e mia, tani nuk më duhesh më.' Nëse në shpirtin tim nuk ka ndryshuar asgjë për mirë, atëherë nuk do të jem prezent në ditën e ardhjes së tij."

## Shërbimi i rojes

Një roje duhet të ruajë, të dallojë rrezikun dhe të lajmërojë të tjerët. Porse një roje nuk mund të luftojë i vetëm kundra armikut dhe as nuk mund të parandalojë sulmet. E njëjta gjë ndodh edhe me besimin: „Si shërbëtor Zoti ne nuk mund të mënjanojmë që bashkësia të sulmohet. Ne nuk mund ta largojmë të keqen nga kjo botë.“ Detyra jonë është, „të dallojmë rreziqet dhe të paralajmërojmë motrat e vëllezërit. Ne nuk mund të luftojmë në vend të bashkësisë, për bashkësinë. Çdo fëmijë Zoti duhet të luftojë vetë për shërimin, shpëtimin e shpirtit të tij; këtë nuk mund ta bëjë prifti për motrën apo vëllanë.“

## Jo sundim, jo të jesh shef

Vëllai i administratës nuk mund të jetë shef mbi besimtarët. „postit ynë nuk është hierarki, që ne të mund të sundonim, qeverisim mbi bashkësinë, që ne të mund të jepnim urdhra në bashkësi dhe që të gjithë ata të na shërbenin ne“, kështu tha drejtuesi i kishës. Një vend i lartë na është dhënë vetëm nëpërmjet shenjtërimin, nëpërmjet thirrjes hyjnore për të shërbyer.



## Një shikim të fortë e të mençur

Një roje duhet të kishte sy të fortë; po të ishte miop, do të ishte pavlerë. Tre faktorë qenë për apostulin kryesor të rëndësishëm, në lidhje me shërbimin në bashkësi:

- Të shikosh nga larg, nga perspektiva e jetës së përjetshme: „Nuk bëhet fjalë vetëm për një mirëqenie tokësore, të jetës së përditëshme. Kujtoni qëllimin, kujtoni ardhjen e Zotit, kujtoni jetën e përjetshme!“
- Të shohësh pa kufi: „Ne nuk mund të vlerësojmë aspak drejt një situatë, nëse nuk do të ishim të ndërgjegjshëm, se jeta vazhdon edhe në botën e përtejme.“ dhe „Ne nuk duhet të shikojmë vetëm bashkësinë tonë të vogël, porse duhet ta kemi parasysh punën e Zotit në përgjithësi.“
- Jo të shohim vetëm vetveten: „Zoti Jezus është shembulli, jo unë! Le të jenë të tjerët krejtësisht ndryshe, kryesorja është, që ai e ndjek pas Zotin Jezus dhe e jeton jetën e tij sipas Ungjillit.“

## Mendime kyçe

Hezeieli 3, 17:

**„Bir njeriu, të kam caktuar si roje për shtëpinë e Izraelit; kur të dëgjosh ndonjë fjalë nga goja ime, do t'i lajmërosh nga ana ime.“**

Vëllezërit e administratës janë thirrur dhe shenjtëruar nga Perëndia për t'i shërbyer atij. Të udhëhequr nga Shpirti i Shenjtë ata paralajmërojnë bashkësinë për rreziqet, që i kërcënojnë dhe bëhen shembull për ta.



# Lere të ndriçojë: Drita triherëshe

Gati 92.000 pjesëmarës morën pjesë në shërbesën fetare me apostulin kryesor Jean-Luc Schneider, ditën e dielë, më 24 Korrik 2016, në Uganda. 3000 prej tyre ishin nga kryeqyteti Kampala, të tjerët e ndoqën shërbesën nëpërmjet transmetimit të televizorit shtetëror, edhe në Tanzani dhe Kenia.

„Jezu Krishti është drita, të cilën Perëndia e dërgoi këtu në tokë.“ Nëpërmjet tij njerëzit njohën Perëndinë, ashtu siç është. Kjo dritë nuk shuhet kurrë. Pasi fitorja në kryq qe përfundimtare, e papërsëritshme dhe e vlefshme përgjithmonë. Për ta përdorur këtë dritë, duhet ta perceptosh atë me besim. „Le të mos e mbulojmë këtë dritë me hallet tokësore“, apeloj drejtuesi i kishës. „Le ta përdorim dritën, për atë që na është dhënë: për të na çuar, drejtuar drejt mbretërisë së Perëndisë.“

## Drita e njohurisë

„Drita është edhe simbol i fjalës së Perëndisë, i mësimëve të Jezusit.“ Pasi ajo tregon ndryshimin midis së mirës dhe së keqes, së drejtës dhe gabimit. Me qëllim që ta përdorësh atë për qëllime personale, duhet që këtë dritë ta bësh tënden dhe të besosh: „Kjo doktrinë e Jezusit prek sot edhe jetën tonë dhe situatën e sotme.“ Edhe këtu do të vrente, të mos e mbulonim dritën, duke mos e zbatuar fjalën e Perëndisë edhe pse e dëgjojmë atë. „Ne e përdorim atë për të ndricuar zemrat tona dhe pikërisht për të përmirësuar sjelljen tonë.“

## Drita e postit, e detyrës

„Apostujt e gjallë kanë marrë detyrën për të qenë mbartësit e kësaj drite në mesin tonë“, me një fjalë për të shpallë Ungjillin dhe për të përgatitur njerëzit nëpërmjet fjalës dhe shenjtërimeve për ardhjen e Krishtit. Për të marrë pjesë në të, duhet të pranosh të dërguarit e tij si dhe mësimet e tyre – me gjithë dobësitë e tyre njerëzore dhe papërsosmëritë. „Ne zëre se e mbulojmë dritën e postit, e detyrës së apostujve, nëse ne nuk e përdorim atë.“

## Drita e dëshmimeve

„Ju jeni drita e botës.“ Me këto fjalë bën thirrje Jezu Krishti për të qenë dëshmitarë të tij, për të dëshmuar se mësimet e tij janë të vërteta dhe se mund të jetosh sipas tyre. „Ne e pranojmë këtë detyrë, çfarëdo që të na ndodhë në jetën tonë, edhe kur përjetojmë dështime e fatkeqësi.“



Foto: NAC Uganda

Përmbledhja e apostulit kryesor: „Le ta lemë gjithnjë nderur dritën e Krishtit për shpëtimin tonë dhe për shpëtimin e tjetrit.“

## Mendime kyce

*Luka, 8,16:*

**„Askush pasi të ketë nderur llambën, nuk e mbulon me një enë ose e fut nën shtrat, por e vë mbi mbajtësen e vet, me qëllim që ata që hyjnë të shohin dritë.“**

Ne e dëshmojmë Jezu Krishtin nga dashuria që kemi edhe për njerëzit e tjerë. Si shërbëtorë Zoti ne kërkojmë shërim, shpëtim. Perëndia na ka dërguar, që t'u dhurojmë në masë të madhe njerëzve të tij kujdesin dhe forcën e duhur, me qëllim që edhe ata të mund të hyjnë në bashkimin e përhershëm me të.



## DAVIDI DHE JONATANI

(1SAMUELIT 18-20)

*Pasi Davidi e mundi filisteun Golia në betejë, jetonte në shtëpinë e mbretit Saul, babain e Jonatanit. Davidi dhe Jonatani janë shokë.*

Në fakt duhet të bëhej Jonatani mbreti i ardhshëm, sepse është biri i mbretit. Por Perëndia zgjodhi Davidin si pasues. Për këtë, Jonatani nuk është xheloz. Davidi është shoku i tij, ai e do atë. Për t'ja treguar këtë, Jonatani i dhuron atij petkun, mantelin, shpatën, harkun dhe rripin e tij. Por mbreti Saul është xheloz ndaj Davidit, pasi ai është një luftëtar i mirë dhe njerëzit duan më shumë atë se sa mbretin.

Sauli sa vjen e zemërohet. Një ditë ai hedh një shtizë drejt Davidit. Davidi mundi t'i shmangej dy herë, por Sauli kërkon që ta vrasë. Jonatani e paralajmëron shokun e tij: „Fshihu deri nesër! Unë do të flasë me babanë tim dhe do të të them se çfarë ka ndërmen të bëjë ai.“

Jonatani flet me babanë e tij dhe ndërhyr për Davidin: „Ai gjithmonë ka luftuar për ty, ai e mundi Golian gjigand, ai s'ka bërë kurrë diçka kundër teje. Pse kërkon të vrasësh një të pafajshëm?“ Aty, Sauli i premtun birin e tij se nuk do t'i bëjë asgjë Davidit. Jonatani e informon Davidin. Davidi u kthye. Por mbreti e harron premtimin e tij dhe hedh përsëri shtizë për nga Davidi. Davidi mezi mundi

t'i shmangej. Ai arratiset në po të njëjtën natë.

Por përsëri kthehet për ta pyetur shokun e tij Jonatanin: „Jonatan, çfarë





kam bërë gabim? Pse kërkon babai yt të më vrasë?”

Jonatani përgjigjet: „Ti s’ke për të vdekur. Babai im do të ma kishte thënë këtë gjë.”

„Po“, thotë Davidi, „por babai yt e di se jemi shokë, ndoshta për këtë arsye nuk të ka thënë gjë.“ Jonatani kërkon ta di nëse Davidi ka të drejtë dhe mendon të kthehet edhe një herë bashkë me një shërbëtor të tij dhe të qëllojë me tre shigjeta. Kur ai t’i thotë shërbëtorit të tij, që zakonisht do t’i mbidhte shigjetat: „Shigjetat ndodhen pas teje“, atëherë çdo gjë është në rregull për Davidin dhe ai mund të kthehet përsëri në shtëpinë e mbretit. Por nëse i thotë shërbëtorit: „Shigjetat ndodhen para teje“, atëherë kërcënon rrezik dhe Davidi duhet të arratiset.

Edhe njëherë të dy shokët i premtojnë besnikëri njëri-tjetrit.

Davidi fshihet  
mbas gurëve  
në fushë.  
Ndërkohë,

në pallat zhvillohet një festë e madhe. Sauli pyet se përse nuk është aty Davidi. Jonatani e mbron mungesën e shokut të tij. Sauli është aq i zemëruar që Jonatani është në anë të Davidit, saqë hedh një shtizë në drejtim të birit të tij. Aty Jonatani e di që Davidi ka të drejtë. Davidi duhet të arratiset.

Në këtë natë Jonatani s’mund të hajë asgjë, kaq i trishtuar është. Me shërbëtorin e tij nis jashtë për në fushë, për ta paralajmëruar Davidin. Ai gjuan tre shigjeta dhe i thërret shërbëtorit:

„Shigjetat ndodhen para teje!“ I jep shërbëtorit të tij harkun me shigjeta dhe e nis përpara atë. Ai dëshiron ta shikojë edhe një herë Davidin.

Të dy qajnë sepse duhet të ndahen.



Davidi u vendos nga Samueli mbret nëpërmjet vajasjes. Si harpist dhe armëmbajtës ai jeton në oborrin mbretëror dhe merr për grua Michalin, vajzën e mbretit. Pas vdekjes së Saulit, ai bëhet me afërsisht 30 vjeç mbret mbi Judean. Shtatë vjet më vonë mbret mbi të gjithë dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Ai pushton Jeruzalemin dhe e bën atë kryeqytetin e ri. Mbretërinë e tij ai e forcon dhe zmadhon me anë të shumë fitoreve mbi popujt fqinj. Davidi sundon nga viti 1004 deri në vitin 965 para Krishtit. Davidi emëron Salomonin si pasues të tij dhe ndërron jetë me afërsisht 70 vjeç në Jeruzalem.





## TEK MAXWELL NË SOVIÉPÉ (TOGO)

A e dini se ku ndodhet Lomé? Jo? Lomé është kryeqyteti i Togos, i një vendi të vogël të Afrikës Perëndimore. Në Togo jetojnë gjashtë milion njerëz, njëri prej të cilëve jam unë, Maxwell. Këtu më shihni me familjen time: babai im Dominique, mamaja ime Edith dhe motra ime Jennifer.




Jenniferi dhe unë luajmë me kënaqësi së bashku. Mamaja këndon në korrin e bashkësisë. Kur ajo shkon në prova korri, shkojmë edhe ne dhe përpiqemi t'i këndojmë gjithashtu këngët që mëson korri.

Unë kam një shok, Davidin. Ai banon në apartamentin përball nesh. Me Davidin luaj me dëshirë shërbesash fetare, pastaj përpiqem të lutem njësoj si babai im. Ai është kryeplak distrikti.

Bashkësia jonë në Soviéapé, e një rajoni të Lomés, është një nga bashkësitë më të mëdha në Togo. Tek ne ka gjithmonë gjallëri: kemi grup që lutet, shkollën e së dielës, mësim feje, shërbesën fetare për fëmijë dhe një korr. Atje unë takoj me kënaqësi fëmijët e tjerë.

Edhe pse jam vetëm katër vjeç, megjithatë shkoj në shkollë. Ndonjëherë, unë ftoj shokët dhe shoqet e shkollës për të shkuar bashkë me mua në shërbesë fetare. Unë gëzoj shumë nëse ata vijnë.





Kur motra ime mbushi një vjeç shkuam me mamin tim, me shokun tim Davidin dhe kushërirën time në plazh. Aty pashë për herë të parë detin!

Davidi dhe unë u kënaqëm në rërë dhe në det, por isha shumë i kujdesshëm pasi nuk di të notoj.

Pas udhëtimit tonë të plazhit vizituam edhe Sheshin e Pavarësisë në Lomé, ai ndodhet përballë Parlamentit të Togos. Më 27 prill 1960 Togo u bë i pavarur, këtë gjë ta kujton një monument i madh në shesh.



Një udhëtim të bën të uritur, aty, pjata ime e preferuar pulë e pjekur në skarë, shijon dy herë më shumë. Meqë ra fjala, edhe makaronat Spaghetti më pëlqejnë shumë.

Unë duhet të ha mirë, pasi sportistët duan shumë energji. Ja, si Davidi dhe unë, ne luajmë futboll në çdo minutë të lirë. Kjo na pëlqern shumë dhe mendoj se jemi tashmë sulmues me të vërtetë të mirë.



# Lutja dhe sakrifica



Foto: © charitetuna1 - Fotolia.com

Në shtator të 2015 doli në shtyp Katekizmi i Kishës Apostolike të Re në formën e Pyetje dhe Përgjigje. Nga gjithsej 750 Pyetje dhe Përgjigje, community na prezanton disa prej tyre – në këtë botim bëhet fjalë për të krishterin apostolik të ri dhe jetën e tij të besimit: lutja dhe sakrifica si dhe martesë dhe familja.

## Çfarë nënkuptojmë me lutje?

Lutja është një mundësi që Perëndia ia ka dhënë njeriut për të kontaktuar me të. Në lutje besimtari ndjen: Perëndia është i pranishëm, Perëndia dëgjon, Perëndia përgjigjet. Kështu njeriu besimtar përkulet me përlulje përpara madhësisë dhe dashurisë së Perëndisë. Shpirti i Shenjtë jep impulse për mënyrën e duhur të të luturit.

## A është e domosdoshme lutja?

Nganjëherë lutja është quajtur si „frymëmarrja e shpirtit“. Kjo figurë duhet ta sqarojë për besimtarin domosdoshmërinë e lutjes. Një besim pa lutje nuk është një besim i gjallë dhe një lutje pa besim nuk është një lutje e vërtetë.

## Cilat udhëzime dha Jezusi për lutjen?

Në predikimin mbi mal Jezusi dha udhëzime të rëndësishme për lutjen (krhs. Mateu 6,5-8): Njeriu nuk duhet ta ekspozojë lutjen e tij dhe as nuk duhet të thotë fjalë të shumta. Perëndisë mund t'i drejtohem me „At“. Lutja duhet të burojë nga zemra. Jezusi në lidhje me rikthimin e tij këshilloi: „Prandaj, rrini zgjuar dhe lutuni kurdoherë që

të çmoheni të denjë të shpëtoni nga të gjitha ato që do të ngjasin dhe të qëndroni para Birit të njeriut“ (Luka 21,36).

## Çfarë thotë Bibla në lidhje me jetën në lutje të Jezusit?

Ungjillet dëshmojnë se Jezusi shpesh tërhiqej për t'u lutur. Tek ungjilli sipas Lukës thuhet se ai lutej veçanërisht para ngjarjeve të rëndësishme si: përpara se Shpirti i Shenjtë të zbriste mbi të (krhs. Luka 3,21.22),

- përpara se të zgjidhte të dymbëdhjetë apostujt (krhs. Luka 6,12),
- përpara se Ati ta tjetërsonte para dëshmitarëve të kësaj dhe të asaj bote (krhs. Luka 9,28-36),
- përpara se të fillonte vuajtja e tij (krhs. Luka 22,41-46),
- përpara se të vdiste në kryq (krhs. Luka 23,46).

Të bën përshtypje që Jezusi në fillim falenderonte, shumë përpara se lutja e tij të dëgjohej (krhs. Gjoni 11,41.42).

## Si duhet të lutemi?

Lutja nuk është e varur prej ndonjë forme të jashtme. Megjithatë, intensiteti i lutjes mund të nxitet si përshebull nëpërmjet mbylljes së syve, bashkimit të duarve ose



gjunjzimit. Lutësi largohet kështu nga nxitimi i jetës së përditshme, ai tërhiqet me qetësi dhe gjunjzohet me përlulje përpara Perëndisë. Të krishterët apostolikë të rinj e fillojnë dhe e përfundojnë ditën me një lutje. Po kështu ata luten edhe përpara ushqimit. Edhe gjatë ditës, i drejtohen herë pas here Perëndisë për ta ndjerë praninë e tij dhe për të kërkuar ndihmën e tij. Në familje prindërit luten me fëmijët e tyre dhe i orientojnë ata në një jetë të tyren në lutje.

### Çfarë përmbajtje ka lutja?

Përmbajtja e lutjes karakterizohet nga adhurimi, falenderimi, lutja për veten dhe për tjetrin.

### Si bëhet adhurimi?

Njohuria mbi madhësinë e Perëndisë të shtyn për ta adhuruar atë: „Ejani, të adhurojmë dhe të përkulemi; të gjunjzohemi përpara Zotit që na ka bërë“ (Psalmi 95,6).

### Çfarë përmban falenderimi në lutje?

Falenderimi në lutje përfshin gjithshka që ka dalë prej mirësisë së Perëndisë: fjala, mëshira dhe shenjtërimet, si dhe të mirat tokësore, si ushqimi, veshja, banimi.

### Cilat kërkesa, dëshira paraqesim para Perëndisë?

Perëndisë i paraqiten të gjitha dëshirat me anë të lutjes që bëjmë për veten. Kjo përfshin ruajtjen në besim, mbrojtjen e engjëjve ose ndihmën e tij në jetën e përditshme. Kërkesa më e rëndësishme i drejtohet rikthimit të shpejtë të Krishtit dhe dëshirës për t'u pranuar më pas me mëshirë.

### Përse bëjmë lutje ndërmjetësuese për tjetrin?

Lutja ndërmjetësuese është shprehje e dashurisë ndaj tjetrit. Ajo nuk kufizohet ndaj bashkësisë apo vetëm ndaj familjes tënde; më tepër ajo përmbledh të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmën e Perëndisë, qoftë në këtë botë apo në atë të përtejmen.

### Çfarë efektesh ka lutja?

Lutja forcon besimin tënd, besimin ndaj Perëndisë dhe dhuron sigurinë e të qënurit i mbrojtur në Perëndi. Lutësi është pas lutjes i sigurt, se të gjitha kërkesat e tija janë tashmë në dorën e Perëndisë: „Vendose fatin tënd tek Zoti, ki besim tek ai dhe ai ka për të vepruar“ (Psalmi 37,5).

### Çfarë është „gatishmëria për sakrificë“?

Në përgjithësi „me gatishmëri për sakrificë“ nënkuptojmë

gatitshmërinë e brëndshme të një njeriut, për të përdorur forcat dhe dhuntitë e tija në të mirë të të tjerëve, duke lënë pas për këtë interesat vetjake..

### Çfarë nënkuptojmë në përgjithësi me fjalën „sakrificë“?

Në të folurin e përditshëm „sakrificat“ janë dhurata, që i ofrohen Perëndisë. Po ashtu me këtë mund të nënkuptohen edhe veprat e njerëzve, që bëhen në shërbim të të tjerëve. Edhe mjetet financiare, të cilat dhurohen për qëllime fetare, janë në të folurin fetar gjithashtu sakrifica.

### Si e kuptojmë ne „sakrificën“ tonë?

„Sakrificën“ tonë ne e kuptojmë si përdorimin e talenteve dhe aftësive tona, kohës dhe forcës sonë, për shërbim të Perëndisë dhe të punës së tij. Gjithashtu sakrificë është edhe kur në të mirë të punës së Perëndisë heqim dorë nga diçka tjetër. Për besimtarin është një dëshirë e madhe që t'ja shprehë Perëndisë mirënjohjen dhe dashurinë e tij edhe nëpërmjet dhuratave (sakrificave) konkrete, qofshin këto mjete financiare apo prodhime të natyrës. Sipas Malakia 3,10 njeriu duhet të sjellë në shtëpinë e Perëndisë „një të dhjetën“ e të gjitha të ardhurave materiale. „Një e dhjeta“ mund të shërbejë si orientim për sakrificën e motrave e vëllezërve të besimit. Së fundmi, gjithshka që besimtari bën ose ndërmerr nga dashuria që ka për Perëndinë, është sakrificë.

### Cila është arsyeja e gatitshmërisë për të sakrificuar?

Sakrifica në kuptimin e krishterë nuk duhet të jetë një shërbim i detyruar, si dhe nuk duhet të qëndrojë në pritje të një shpërblimi. Gatitshmëria për sakrificë rritet shumë më tepër nga besimi, mirënjohja dhe nga dashuria kundrejt Perëndisë.

### Si tregohet gatishmëria për sakrificë në jetën në bashkësi?

Gatishmëria për të sakrificuar reflektohet direkt në jetën në bashkësi: Shumë prej morave e vëllezërve të besimit sjellin vullnetarisht një sasi të konsiderueshme të kohës së tyre të lirë, të forcës dhe të dhuntive të tyre në shërbim të bashkësisë. Shumë kontribuojnë në muzikë dhe në mësimdhënie. Vetëm me disa përjashtime edhe vëllezërit e administratës punojnë në mënyrë vullnetare.

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 233, 8051 Zyrih/Svicër

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 23, 63263 Neu-Isenburg/Gjermani

Redaktori: Peter Johanning



Foto: © Studio Romantic - Fotolia.com

## | Martesa dhe familja

### Çfarë është martesë?

Martesa është bashkëjetesa e burrit dhe gruas, të cilën Perëndia e vë nën bekimin e tij. Ajo krijon bazën për familje. Baza e saj është një premtim besnikërie, të cilin çifti ia jep njëri-tjetrit me vullnet të lirë. Dashuria dhe besnikëria e ndërsjelltë janë thelbësore për suksesin e martesës. Martesa me shumë partnerë (poligamia) nuk është në përputhje me mësimet dhe traditën e krishterë.

### Çfarë mund të nxjerrim si konkluzion nga historia e krijimit për martesën?

„Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëllimit të tij. Krijoi mashkullin e femrën i bekoji dhe ju tha: „Shtohuni dhe shumëzohuni, që pasardhësit tuaj të popullojnë gjithë tokën dhe ta zotërojnë atë“ (Zanafilla 1,27.28). – Që të dy, burrë e grua janë krijuar si shëmbëllitë e Perëndisë. Në mënyrë të ndryshme por të barazvlefshme qëndrojnë që të dy nën bekimin e tij. Njeriu është krijuar për të qenë në

shoqëri; tek bashkëshorti burri dhe gruaja kanë përballë dikë, për të cilin duhet të jenë një ndihmë. „Pastaj Zoti, Perëndi tha me vete: Nuk është mirë që njeriu të mbetet vetëm; do t'i bëj një shoqe që të jetë e përshtatshme për të“ (Zanafilla 2,18). Me kurorëzimin e martesës, burri dhe gruaja bashkohen për të formuar një njësi të vetme, që është e vlefshme për të gjithë jetën: „Prandaj njeriu e lë babanë dhe nënën dhe bashkohet me gruan e tij dhe të dy këta bëhen një“ (Zanafilla 2,24).

### Çfarë kuptimi ka bekimi i martesës?

Bekimi i martesës mund të ndikojë në mënyra të ndryshme: Ai fuqizon forcën për një dashuri dhe besnikëri të përhershme; ai nxit gatitshmërinë për shërbim, ndihmë dhe mirëkuptim; ai ndihmon që gabimet të falen dhe që të jesh i gatshëm për pajtim. Megjithatë, bekimin që ata e marrin mund të ketë efekt vetëm atëherë, kur bashkëshortët sillen në përputhje me të.



### **Çfarë kuptimi ka besimi i krishterë për qëndrueshmërinë e martesës?**

Është e dëshirueshme që bashkëshortët të kenë të njëjtën rrugë besimi. Sidoqoftë, fakti që bashkëshortët janë të dy të krishterë, nuk është një garanci për një jetë të harmonishme martesore. Veçanëshirt atëherë, kur një bashkëshort i përket një rrethi tjetër kulture, feje apo besimi, duhet të jenë sqaruar të gjitha pyetjet rreth jetës së përbashkët përpara kurorëzimit.

### **Çfarë kuptimi ka seksualiteti në martesë?**

Kur mirëkuptimi i ndërsjelltë dhe dashuria qëndrojnë në rradhë të parë, seksualiteti si një lidhës i rëndësishëm mund ta forcojë bashkëjetesën martesore dhe mund të kontribuojë në ndjerjen mirë të të dy bashkëshortëve. Seksualiteti në martesë duket të bazohet në vlerësimin dhe aftësinë për ta kuptuar tjetrin.

### **Si qëndron Kisha Apostolike e Re ndaj planifikimit familjar?**

Planifikimi familjar është çështje e bashkëshortëve. Megjithatë, kisha i refuzon metodat e ndryshme kontraceptive që kanë si qëllim kryesor vrasjen e qelizës të ngjizur tashmë. Ngjizja artificiale pranohet në përgjithësi; por refuzohen të gjitha masat e marra të zgjedhura nga njeriu për të shuar jetën e krijuar.

### **Çfarë qëndrimi mban Kisha Apostolike ndaj realizimit të detyrave në punë dhe shoqëri?**

Orientim për realizimin e detyrave në punë dhe shoqëri japin dhjetë urdhërimet. Është detyrë e të krishterëve për të kontribuar në të mirë të shoqërisë. Gjithkush është bashkëpërgjegjës për këtë.

### **Cila është përgjegjësia e Kishës Apostolike të Re në shoqëri?**

Brënda mundësive dhe detyrës së saj, Kisha Apostolike e Re ndihmon në nxitjen e mirëqënies së përbashkët të njerëzve. Kisha Apostolike e Re kontribuon për paqen në botë, bën thirrje për pajtim dhe e kërkon faljen. Ajo refuzon çdo lloj dhune.

### **A marrin pjesë të krishterët apostolikë të rinj në jetën publike?**

Po, të krishterët apostolikë të rinj marrin pjesë në jetën publike. Kisha nuk ushtron asnjë ndikim mbi pikëpamjet politike dhe veprimtaritë e anëtarëve të saj. Kisha Apostolike e Re i inkurajon të gjithë anëtarët e saj që t'i takojnë të gjithë njerëzit me respekt dhe tolerancë, pavarësisht origjinës shoqërore, moshës, gjuhës dhe dallimeve të tjera.

### **Cili është raporti i Kishës Apostolike të Re ndaj shtetit?**

Kisha Apostolike e Re vlerëson marrëdhëniet e hapura dhe konstruktive ndaj qeverisë dhe autoriteteve. Ajo është neutrale për sa i përket partive politike. Në veprimet e saja ajo orientohet sipas ligjeve të vendeve përkatëse, duke marrë parasysh letrën drejtuar Romakëve 13,1 ku shkruhet: „Çdo njeri le t'i nëshetrohet pushteteve të sipërme, sepse nuk ka pushtet veçse prej Perëndisë; dhe pushtetet që janë, janë caktuar nga Perëndia“. Kjo kërkon që edhe autoritetet shtetërore duhet të maten me urdhëresat e Perëndisë. Kisha plotëson detyrimet dhe përgjegjësitë e saja sipas ligjeve dhe rregullave të vendit përkatës. Por ajo pret nga ata, që edhe ajo të respektohet dhe të njihet në pozicionin e saj.

### **Si është marrëdhënia e Kishës Apostolike të re ndaj kishave të tjera, bashkësive fetare dhe feve të tjera?**

Kisha Apostolike e Re dhe anëtarët e saj i respektojnë praktikat fetare të të tjerëve dhe nuk nënvleftësojnë besimtarët e feve të tjera, fetë dhe bashkësitë e ndryshme fetare. Ata përpiqen për një marrëdhënie të mirë dhe paqësore të bazuar në respekt të ndërsjelltë. Kisha refuzon çdo lloj fanatizmi fetar. Në dialog me kishat e tjera të krishtera – pavarësisht nga pozicionet e ndryshme të mësimdhënies – theksohen ngjashmëritë e besimit të krishterë.

### **Si është angazhimi social i Kishës Apostolike të Re?**

Kisha Apostolike e Re ecën vetëm sipas Ungjillit. Ajo e shikon detyrën e saj ndër të tjera në „zbatimin e dashurisë ndaj tjetrit“, e cila i bën mirë njerëzve pa dallim. Ky angazhim shoqëror, mbështetet prej shumë ndihmësve vullnetarë të bashkësive, por edhe prej ndihmesave materiale. Kisha planifikon, nxit dhe ndihmon, brënda mundësive të saja, projekte që i bëjnë mirë e i shërbejnë shoqërisë, kryen organizime dhe jep ndihmëse në të gjithë botën, edhe në bashkëpunim me organizata bamirësie.

# Pasqyra

01.01.2017	Bern/Svicër
08.01.2017	Berlin/Gjermani
15.01.2017	Togo Lomé/Togo
20.01.2017	Sarh/Çadi
21.01.2017	Koumra/Çadi
22.01.2017	N'Djamena/Çadi
12.02.2017	Kulmbach/Gjermani
17.02.2017	Guiné-Bissau/Guineja-Bizare
18.02.2017	Guiné-Bissau/Guineja-Bizare
19.02.2017	Sédhiou/Senegal
24.02.2017	Mpumalanga/Afrika e Jugut
26.02.2017	Durban/Afrika e Jugut
05.03.2017	Neumünster/Gjermani
12.03.2017	Saskatoon/Kanada
14.03.2017	Quebec/Kanada
19.03.2017	Wuppertal/Gjermani
26.03.2017	Evreux/Francë

